



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
GRAMSH

Nr 594/
2

Gramsh, më 16/02/2026

VENDIM

NR.13. Datë 12.02.2026

Për

Miratimin e shumës së bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave
ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara

Këshilli i bashkisë Gramsh në mbledhjen e tij të dates 12.02.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e Sektorit të Emergjencave Civile dhe Strehimit "Për miratimin e shumës së bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", në mbështetje të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 "Për strehimin social", në VKM nr. 454, datë 03.07.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", në Udhëzimin e MFE, nr.31, dt.18.11.2019, "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2;

Vendosi:

Të miratohet shuma e bashkëfinancimit për projektin e përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara në masën është **26,998,814.64** lekë, për 69 familje në nevojë bazuar në programet sociale për strehimin e banorëve të bashkisë Gramsh me qëllim përfitimin e fondeve buxhetore.

- I. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari I Bashkisë, Sektori I Emergjencave dhe Strehimit si dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.
- II. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë
Xhulia GJINI

Kryetari i Këshillit të Bashkisë
Enis ZANI

